



VENDIM
Nr. 272, datë 3.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
LOTIN 1 ME OBJEKT “BLERJE KITE
PËR LABORATORIN MIKROBIOLOGJIK
PËR REALIZIMIN E RT-PCR TË
PËRSHTATSHËM PËR T’U PËRDORUR
PËR PAJISJEN E EXISTATION TË
FIRMËS BIONEER OSE EKVIVALENT”
PËR QSUT-NË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 1 me objekt “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t’u përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalent” për QSUT-në, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “O.E.S DISTRIMED”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë me objekt “Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje antiCOVID-19 ndarë në dy lote”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama